L I G J
Nr.8799, datë 17.5.2001

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE TË ZHVILLIMIT PËR PROJEKTIN E FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM DHE PËR KANALIZIMET NË FUSHË-KRUJË DHE PESHKOPI"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K UV E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Islamike të Zhvillimit për projektin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në Fushë-Krujë dhe Peshkopi".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3041, datë 5.6.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJA E HUASË
MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BANKËS SË ZHVILLIMIT ISLAMIK PËR PJESËMARRJEN NË FINANCIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E UJËSJELLËSIT TË FUSHË - KRUJËS DHE PESHKOPISË

Kjo marrëveshje është bërë me _____/_____/ midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (më pas i quajtur Huamarrësi) dhe Bankës Islamike të Zhvillimit (më poshtë e refeuar "Bankë")

NDËRSA

(A) Huamarrësi i ka kërkuar Bankës të ndihmojë në financimin e pjesës së kostos së Projektit të ujësjellësit në Fushë-Krujë dhe Peshkopi siç përshkruhet në Listën II të kësaj marrëveshjeje me përpilimin e Huasë si parashikohet më pas.

(B) Një nga qëllimet e Bankës është të ndihmojë anëtarët e vendeve të saj në mënyrën e përpilimit të huasë për financimin e programeve dhe projekteve produktive.

(C) Projekti është menduar të jetë i rregullt teknikisht, i përligjur ekonomikisht dhe financiarisht.

(D) Banka ka rënë dakort të japë Huanë tek Huamarrësi duke u mbështetur në termat dhe konditat e vendosura.

TANI.....Palët kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Kushtet e përgjithshme

1.01 Kushtet e përgjithshme. Palët në këtë Marrëveshje pranojnë të gjitha vendimet e Kushteve të Përgjithshme aplikuar tek Marrëveshja e Huasë dhe Garancisë së Bankës, dhënë më 8.11.1976 (më pas quajtur Kushtet e Përgjithshme) me të njëjtën forcë dhe efekt sikur ishin vendosur

më parë këtu.

1.02 Përcaktimet. Kurdoherë të përdorura në këtë marrëveshje, veç kontekstit të kërkuar në rast të kundërt, disa terma të përcaktuar në Kushte të Përgjithshme, kanë kuptime respektive vendosur këtu më pas dhe termat shtesë më poshtë kanë kuptimet e mëposhtme:

(a)Të dhënat Efektive, nënkupton të dhëna me të cilat Marrëveshja është deklaruar efektive nga Banka, siç është komunikuar tek Huamarrësi nga Banka.

(b)Agjencia Ekzekutive, nënkupton Ministrinë e Punëve Publike e cila është Agjenci Ekzekutive përgjegjëse për kryerjen, veprimin dhe drejtimin e Projektit.

(c) Projekti, duke iu referuar "Palëve" këtu, nënkupton projektin dhe pjesët e përshkruara në Listën II të kësaj Marrëveshjeje.

(d) Dinari Islamik (ID) i përcaktuar në Nenin 4(1) (a) të nenit të Marrëveshjes të vlerësuar nga Banka, është një njësi e llogarisë së Bankës. Një ID është ekuivalente me një të drejtë tërheqje speciale të FMN-së.

Neni 2
Huaja

2.01 Shuma. Banka ra dakort të japë hua tek Huamarërsi, prej burimeve të saj të zakonshme, një shumë jo më tepër se ekuivalentja ID 4 990 000 (Dinare Islamikë).

2.02 Përveç çfarë Banka do të bjerë dakord, kontratat për mjetet dhe shërbimet që do të financohen jashtë të ardhurave, të kësaj Huaje në rast të kundërt do të jenë siguruar në lidhje me procedurat e vendosura nga Banka. Në lidhje me këtë Huamarrësi do t'i nënshtrohet Rregullores së Organizimit të Konferencës Islamike në lidhje me Boycottin e Izraelit.

Neni 3
Amortizimi, pagesa e shërbimeve dhe vendet e pagesave

3.01 Amortizimi. Huamarrësi do të kthejë shumën e huasë në 25 vjet periudhë garancie, duke përfshirë 7 vite periudha kësti, duke filluar prej datës së kësaj marrëveshjeje në 36 këste të barabarta dhe të vazhdueshme, gjysëm vjetor të vendosur në Listën 1 (A) të kësaj Marrëveshjeje.

3.02 Pagesa e shërbimit

(a) Huamarërsi do t'i paguajë Bankës një Pagesë Shërbimi të një shume, vlerësuar fillimisht në 281 536 ID, në mënyrën e vendosur në Listën 1 (B) të kësaj Marrëveshjeje.

(b) Është kuptuar dhe rënë dakord midis palëve këtu që shuma fillestare e pagesës së shërbimit, referuar pikës 3,02 (a) është jo më shumë së një vlerësim bazuar në marrjen përsipër të periudhës së kryerjes dhe periudhës së disbursimit të shumës së plotë të Huasë siç është shqyrtuar këtu. Më tej është rënë dakord që shuma aktuale e pagesës së Shërbimit do të llogaritet pas kryerjes së projektit me kusht që shuma aktuale e llogaritur s'do të kalojë 2.5.% të shumës së Huasë për vit.

(c) Pagesa e shërbimit do të rritet prej datës së kësaj Marrëveshje.

3.03 Vendet e Pagesave. Të gjitha pagesat, duke përfshirë edhe pagesat e principalit, që do të bëhen në kohën e duhur kur fondet e caktuara për pagesa të tilla janë kredituar në një llogari të treguar për këtë qëllim nga Banka.

3.04 Pa dëmtuar gjithësinë e vendimeve të pikës 3.03, të gjitha pagesat mendohen se duhen paguar:

(a) Në qoftë se pagesa është bërë në dollarë, kur cilado nga bankat e mëposhtme, konfirmon te IDB-ja, dëftesë pagimi me pagesë të tillë në llogarinë e Bankës Islamike të Zhvillimit me:

Account No.159111
Gulf International Bank (UK) Limited (GIB)
One Knightsbridge
London SËIX 7XS
United Kingdom
Telex No.8812261/2 SAUDI G
SËIFT CODE: SINTGB2L

Account No. B10507
Arab Banking Corporation
P.O.Box: 5698, Manama, Bahrain
Telex Numbers: 9385, 9431/2/3, 9442 ABCBAH BN.

(b) Në qoftë se një pagesë e tillë është bërë në franga franceze, kur Banka e mëposhtme e konfirmon tek IDB-ja, dëftesën e pagimit me pagesë të tillë në llogarinë e Bankës Islamike të Zhvillimit me këtë numër:

Account No. 96965.9.001.00
Union De Banques arabes Et
Francaises (U.B.A.F.)
190 Avenue Charles de Gaulle
92523 Neuilly Cedex, France
telex Number: 610334. UBAFRA

(c) Në qoftë se pagesa është bërë në stërlina, kur Banka e mëposhtme konfirmon tek IDB-ja, dëftesën e pagimit me pagesë të tillë në llogarinë e IDB-së me:

Account No. 122432 GBP2520.01
Gulf International Bank B.S.C.
75 King Ëilliam Street
London EC4N 7DX
United Kingdom
Telex No. 8812889/8813326 GIBANK G
SËIFT CODE: GULFGB2L

(d) Në qoftë se pagesa është bërë në EURO, kur Banka e mëposhtme e konfirmon tek IDB-ja, dëftesën e pagimit me pagesë të tillë në llogarinë e Bankës Islamike të Zhvillimit me:

Account No. 096965 000 51
Union De Banques Arabes e Francaices (UBAF)
92523 Paris, Neuilly Cedex
France
Telex No. 610334 UBAF
SËIFT CODE: UBAFRPPXXX

Neni 4

Tërheqja dhe pëdorimi i të ardhurave nga huaja

4.01 Tërheqjet. Shuma e Huasë mund të tërhiqet nga Huamarrësi duke pranuar Listën (iii) dhe vendimet e kësaj Marrëveshjeje, kushtet e përgjithshme dhe procedurat e pagesës së Bankës, për qëllimet e vendosura më tej në këtë marrëveshje, për shpenzimet e bëra në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe të miratuara për t'u financuar nga kjo Marrëveshje.

4.02 Të dhënat e kërkuara për disbursimin e parë. Në kufirin e 180 ditëve, datës efektive ose një date të tillë më pas, si të jenë rënë dakort midis Huamarrësit dhe Bankës, kur Huamarrësi nuk ka paraqitur një kërkesë tek Banka për të bërë pagesën e parë, Banka, mund të kufizojë këtë marrëveshje mbi shënimin e përcaktuar nga Huamarrësi.

4.03 Data e mbylljes. 30 prill 2004 ose data më vonë se të jetë rënë dakort midis Huamarrësit dhe Bankës, është data e mbylljes së tërheqjes prej huasë për qëllimin e pikës 6.03 (c) të Kushteve të Përgjithshme.

4.04 Përdorimi i të ardhurave nga huaja. Të gjitha shumat e tërhequra nga Huamarrësi prej

llogarisë së Huasë do të përdoren vetëm për qëllimet e projektit të financuar nga Banka.

Neni 5
Ekzekutimi i projektit

5.01. Huamarrësi merr përsipër të:

a) kryejë projektin dhe të drejtojë veprimet dhe punën e tij nëpërmjet Agjencisë Ekzekutive me efiçencën dhe kujdesin e përshtatshëm dhe në lidhje me aftësinë ekonomike, inxhinierike, financiare administrative të rregullta, nën mbikqyrjen e personelit të kualifikuar dhe të drejtimit me eksperiencë dhe në lidhje me listën e investimeve, buxhetin, planet dhe specifikimeve përsa i përket projekit të paraqitur dhe të aprovuar nga Banka.

b) paraqitja në bankë për aprovim, me detaje të tilla, të kërkuara nga Banka mund dhe me ndonjë modifikim të rëndësishëm të shqyrtuar në Buxhet, planet dhe specifikimet e projektit po aq sa ndonjë ndryshim i bazuar në ndonjë kontratë për shërbimet ose sigurimin e mjeteve në lidhje me kryerjen e projektit.

5.02. Pa ndonjë kufizim mbi ndonjë nga detyrimet e tjera në këtë marrëveshje, Huamarrësi do t'i lejojë Bankës një periudhë kohe të arsyeshme të komentojë ndonjë ndryshim të rëndësishëm ose ndonjë zgjatje e afatit të parashikuar bazuar në ndonjë kontratë për shërbimet ose sigurimin e mjeteve në lidhje me kryerjen e projektit.

Neni 6
Plotësimi i parakërkesave para pagesës nga banka

Huamarrësi, para paraqitjes së kërkesës së parë për tërheqje, do të tregojë procedurën që ky propozon të ndjekë ose çështjet që do të ndiqen për konkurencën e propozuar në pajtim me pikat 2.02 dhe 7.02 të kësaj Marrëveshjeje dhe marrjen e aprovimit të bankës atje.

Neni 7
Pakti i posaçëm

7.01 Huamarrësi do të bëjë të përshtatshme shpejt, sikurse nevojitet, të gjitha shumat e përfshira në koston rrjedhëse lokale dhe koston e rritur, e cila do të kërkohet për të kryer Projektin, në termat dhe kushtet e kënaqshme të Bankës.

7.02 Përjashtuar kur rastet e Bankës mendohen ndryshe, Huamarrësi do të pranojë të gjitha kontratat e financuara nga procedura e kësaj Huaje për ekzekutimin e projektit nëpërmjet tenderit të kufizuar ndërkombëtar me vendet anëtare të Bankës dhe do të shikojë me prioritet të Bankës për pranimin e ndonjë kontrate vlera e së cilës e kalon ekuivalenten 150 000 ID (Dinarë Islamikë).

7.03 Huamarrësi do të furnizojë menjëherë Bankën pas aprovimit të tyre në lidhje me studimet e Huamarrësit, planet dhe specifikimet për projektin, organizimin e zbatimit të tij dhe ndonjë material të modifikuar, në detaje të tilla që Banka do të kërkojë kohë pas kohe.

7.04 Huamarrësi do të vendosë dhe do të mbajë dokumentet e duhura për të identifikuar mjetet e financuara jashtë procedurave të Huasë, për të zbuluar përdorimin e tyre në projekt, të dokumentojë ecjen e projektit, dhe të reflektojë në përputhje me zërat dhe praktikat dhe veprimet e kontabilitetit, si dhe gjendjen financiare të Agjencisë Ekzekutive.

7.05 Huamarrësi do të jetë në gjendje të japë të gjithë vlerësimet e arsyeshme përfaqësuesve kreditues të Bankës, të bëjë inspektime për propozime në lidhje me Huanë dhe të kontrollojë Projektin, të ardhurat dhe ndonjë dokument lidhës me të, si dhe t'i japë Bankës gjithë informacionin e duhur. Kështu Banka do të kërkojë informacion mbi shpenzimet dhe të ardhurat e Projektit, të mjeteve, veprimeve dhe pozitës financiare të Agjencisë Ekzekutive.

7.06 Huamarrësi merr përsipër për vënien në zbatim të Projektit, të bëjë ndryshime të përshtatshme në mënyrë që Agjencia Ekzekutive në sa më pak kohë të veprojë në rregullat e pëlqyeshme të Bankës, dhe të ketë fuqi të tilla menaxhimi e administrimi që janë të nevojshme për vënien në zbatim të mënyrë efektive dhe krijuese Projektin.

7.07 Huamarërsi do të sigurojë ose kërkon të sigurohet me siguracione të gjithë të ardhurat financiare jashtë procedurave të Huasë. Të tilla siguracione do të mbulojnë transportin detar, rreziqet

kalimtare ose aksidentale të blerjes dhe importimit të gjërave në territorin e Huamarrësit dhe të japë të gjithë anën e Projektit, e do ta bëjë këtë për shuma të tilla që janë të qëndrueshme me praktikat e këtij zëri tregtar. Të tillë siguracion do ta bëjë në lidhje me ligjet e Huamarrësit duke siguruar që materialet do të sigurohen në një kompani që do të paguajë me procedurat e sigurimit në monedhë të huaj.

7.08 Huamarrësi do të ndërmarrë veprime të tilla që nevojiten për të bërë të përshtatshme dhe kur nevojitet, vendin dhe të drejtat mbi tokën që do të kërkohen për të kryer Projektin dhe do të furnizojë Bankën, sipas kërkesave të saj, evidencën që të tilla vende dhe të drejta në lidhje me tokën janë të përshtatshme për qëllimet e Projektit.

7.09 Huamarrësi do të vendosë gjithë veprimin, i cili do të jetë i nevojshëm për pjesën e tij t'i përshtatet Agjencisë Ekzekutive që të zbatojë projektin dhe të mos lejojë të vendoset ndonjë kufizim, i cili do të parandalonte ose ndërhynte në zbatim të Projektit ose krijimit të ndonjë klauzole të Kontratës.

7.10 Të gjitha dokumentet e Bankës, regjistrimet, korrespondencat dhe materiale të ngjashme do të konsideohen nga Banka dhe Huamarrësi si materiale konfidenciale.

Neni 8
Raportet

8.01. (a) Huamarrësi dhe Banka do të bashkëpunojnë për të siguruar që qëllimet e Huasë të përmbushen. Së fundi secili prej tyre do të furnizojë tjetrin me të gjitha informacionet që janë kërkuar në lidhje me të dhënat e përgjithshme të Huasë. Nga pjesa e Huamarrësit informacione të tilla do të përfshijnë informacione me kushte të veçnata financiare dhe ekonomike në territorin e dhënë me balancën e pagesave në pozitën e Huamarrësit.

(b) Huamarrësi dhe Banka herë pas here nga kërkesa e secilës pjesë, do të shkëmbejnë pikëpamje nëpërmjet paraqitjeve të tyre në lidhje me çështjet e qëllimit të Huasë, mirëmbajtjes së shërbimeve, nga ku dhe kryerjen e detyrimeve nën këtë kontratë.

8.02. (a) Huamarrësi merr përsipër të sigurojë paraqitjen ose arsyet e paraqitjes në Bankë, të kërkesave të fundit dhe në kohën e specifikuar për secilën, e raporteve si më poshtë:

i- Brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo 3 mujori ose brenda një periudhe tjetër që mund të vendoset midis palëve, raportohet për ekzekutimin e projektit në mënyrë të tillë siç mund ta specifikojë Banka kohe pas kohe.

ii- Raporte të tjera që Banka i kërkon në mënyrë të arsyeshme lidhur me investimin e shumave të Huave, të shlyera dhe me progresin e Projektit.

iii- Menjëherë pas kompletimit të Projektit, për çdo rast jo më vonë se 6-muaj pas datës së mbylljes apo të një date tjetër të rënë dakort për këtë qëllim midis Bankës dhe Huamarrësit, ky i fundit do t'i përgatisë dhe sigurojë Bankës një raport të plotë për këtë qëllim dhe me aq hollësira sa t'i kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme, lidhur me ekzekutimin dhe operacionin fillestar të Projektit.

(b) Dokumentet e përshkruara në këtë sesion do të certifikohen sipas këkesës së Bankës.

Neni 9
Efektiviteti dhe data e kryerjes

Kjo kontratë nuk do të jetë efektive deri kur:

A) 1) Bankës t'i jetë siguruar një evidencë e kënaqshme që ekzekutimi dhe dhënia e kësaj kontrate në përfitim të Huamarrësit është autorizuar dhe ratifikuar siç duhet nga të gjitha veprimet e nevojshme qeveritare.

2) Huamarrësi do të sigurojë një opinion ligjor të pranueshëm për Bankën, të nxjerra nga autoritetet ligjore lokale që deklarojnë se është autorizuar dhe nënshkruar si duhet në përfitim të Huamarrësit. Deklarimi do të vendosë që kontrata përbën një detyrim te Huamarësit. Deklarimi do të vendosë që kontrata përbën një detyrim te Huamarrësit në lidhje me termat e tij.

B) Duhet të shoqërohet me një letër autorizimi nga Ministria e Financave apo organ tjetër qendror i autorizuar për Bankën Qendrore apo për një institucion tjetër që merr funksionet e Bankës Qendrore, duke instruktuar Bankën e lartpërmendur që pagesa nga Qeveria sipas kësaj kontrate të Huasë dhe shpenzimet e shërbimit të instalimit do të kryhen nga Banka Qendrore apo institucion tjetër që merr funksionet e Bankës Qendrore në datat e përcaktuara prej tyre.

Një kopje e kësaj letre Autorizimi së bashku me një vërtetim nga Banka Qendrore (apo institucion tjetër njehsuar me të) që tregon se e ka marrë Letrën e Autorizimit të lartpërmendur dhe që ajo do t'i bashkëngjitet instruksioneve që përmbahen në të, do të paraqitet nga Qeveria për Bankën.

Neni 10
Përfundimi i kontratës në rast falimentimi

Në rast se kontrata nuk ka hyrë në zbatim deri në 14 mars 2002, kontratat, me të gjitha detyrimet e palëve do të përfundojnë së pari nga Banka, pas konsideratës të të gjitha arsyeve; për shtyrjen do të caktojë një datë të mëvonshme për qëllim të këtij paragrafi.

Banka menjëherë do të njoftojë huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Neni 11
Klauzola të përbashkëta

11.01. Përfaqësuesit e autorizuar. Ministri i Financave tek Humarrësi dhe tek ndonjë person ose grup që ka përcaktuar me shkrim si përfaqësues të autorizuar të Huamarrësit për qëllimet e paragrafit 10.03 të Kushteve të Përgjithshme.

11.02. Data e kontratës. Për qëllimet e kësaj kontrate data që nga deri kur do të jetë ajo që paraqitet në pjesën hyrëse të kontratës.

11.03. Adresat. Adresat e mëposhtme specifikohen për qëllimet e paragrafit 10.01 të Kushteve të Përgjithshme.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
Ministria e Financave
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Telefax:(355-42) 28494 dhe 29200

Për Bankën e Zhvillimit Islamik:
B.O. Box: 5925
Jeddah 21432
Mbretëria e Arabisë Saudite
Teleks: 601137ISDBSJ
Kablli:BANKISLAMIJEDDAH
Telefax:6366871 JEDDAH

Në përgjegjësinë e tyre. Banka dhe Huamarrësi, akti me të cilin autorizohen përfaqësuesit, kanë nënshkruar këtë marrëveshje në gjuhën angleze në datën e shkruar.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë:

_____

Në emër të Bankës Islamike

_____

LISTA I(A)

PAGESAT E PRINCIPALIT

Shteti: Shqipëri
Projekti: Përmirësimi i sistemit të ujësjellës-kanalizime në Fushë-Krujë dhe Peshkopi.
Shuma e Kredisë: ID 4 990 000
Periudha e Kredisë: 25 vjet
Periudha e pagesës së kësteve: 7 vjet

Pagesa e shërbimit: ID 281536

KËSTI	DATA	PRICIPALI (ID)
1.	31/12/2009	138 611
2.	30/6/2010	138 611
3.	31/12/2010	138 611
4.	30/6/2011	138 611
5.	13/12/2011	138 611
6.	30/6/2012	138 611
7.	31/12/2012	138 611
8.	30/6/2013	138 611
9.	31/12/2013	138 611
10.	30/6/2014	138 611
11.	31/12/2014	138 611
12.	30/6/2015	138 611
13.	31/12/2015	138 611
14.	30/6/2016	138 611
15.	31/12/2016	138 611
16.	30/6/2017	138 611
17.	31/12/2017	138 611
18.	30/6/2018	138 611
19.	31/12/2018	138 611
20.	30/6/2019	138 611
21.	31/12/2019	138 611
22.	30/6/2020	138 611
23.	31/12/2020	138 611
24.	30/6/2021	138 611
25.	31/12/2021	138 611
26.	30/6/2022	138 611
27.	31/12/2022	138 611
28.	30/6/2023	138 611
29.	31/12/2023	138 611
30.	30/6/2024	138 611
31.	31/12/2024	138 611
32.	30/6/2025	138 611
33.	31/12/2025	138 611
34.	30/6/2026	138 611
35.	31/12/2026	138 611
36.	30/6/2027	138 611
TOTALI		4 990 000

LISTA I (B)

PAGESA E SHËRBIMIT

Shteti: Shqipëri
Projekti: Përmirësimi i sistemit të ujësjellës-kanalizime në Fushë-Krujë dhe Peshkopi.
Shuma e Kredisë: ID 4 990 000
Periudha e kredisë: 25 vjet
Periudha e pagesës së kësteve: 7 vjet
Pagesa e shërbimit: ID 281536

KËSTI	DATA	PAGESA E SHËRBIMIT (ID)

1	31/12/2001	5 631
2	30/6/2002	5 631
3	31/12/2002	37 538
4	30/6/2003	37 538
5	31/12/2003	37 538
6	30/6/2004	15 766
7	31/12/2004	15 766
8	30/6/2005	15 766
9	31/12/2005	15 766
10	30/6/2006	15 766
11	31/12/2006	15 766
12	30/6/2007	15 766
13	31/12/2007	15 766
14	30/6/2008	15 766
15	31/12/2008	15 765
TOTALI		281 536

LISTA II

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i projektit është të përmirësojë sistemin sanitar të furnizimit me ujë në qytetet e Fushë-Krujës dhe Peshkopisë nëpërmjet përmirësimit dhe zgjerimit të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve dhe gjetjes së burimeve të reja. Qëllimi kryesor i Projektit synon rritjen e standartit të jetesës dhe garantimit të shëndetit të popullsisë në qytete.

Projekti përfshin punët publike, supevizionin, shërbimet e konsulencës, dhe shpenzimet për PIU-n përkatës. Punët publike janë në formën e shtrirjes dhe furnizimit të rrjetit të ujësjellësave, rrjetit të kanalizimeve, ndërtimit të rezervuarve të ujit, klorinimit të tij, stacioneve të pompimit, pompave shtëpiake, hapjes së puseve të ujit dhe zhvillimit të burimeve ujore (që përfshin strukturën, mbrojtjen, mbledhjen dhe lidhjen e tubacioneve), furnizimi dhe instalimi i matësave të ujit, shërbimet e kanalizimeve dhe punët e tjera publike.

LISTA III

TËRHEQJA E TË ARDHURAVE

KOMPONENTËT	KOSTO (US MILION)
1. Punët Publike	5.128
2. Shërbimet e Konsulencës dhe të Supervizionit	0.650
3.PIU	0.050
4. Kontigjenti	0.758
TOTALI	6.586